VENDIM
Nr. 31, datë 18.1.2017

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN
NR. 824, DATË 6.12.2006, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E INSTITUCIONEVE TË AUTORIZUARA PËR VERIFIKIMIN, NË MËNYRË ELEKTRONIKE, TË GJENDJES GJYQËSORE, SI DHE TË FORMULARIT TË VETËDEKLARIMIT",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 7, 8 e 11, të ligjit nr. 9614, datë 21.9.2006, "Për certifikatat elektronike të gjendjes gjyqësore", me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në kreun I, të vendimit nr. 824, datë 6.12.2006, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhet kjo shtesë:
1. Pas pikës 44 shtohet pika 45, me këtë përmbajtje:
"45. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.".
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi